



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
**BASHKIA MALLAKASTËR**

**KËSHILLI BASHKIAK**

Ballsh më, 29.07.2025

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Mallakastër. Kryesues i mbledhjes është Z. Nexhmi Sulaj. Ora e mbledhjes: 10:00. Kryesuesi i mbledhjes deklaroi kuorumin prej 11 anëtarësh. Të pranishëm nga administrata: Znj. Armela Malaj, Znj. Laureta Saliaj, Z. Aleksandër Ramaj, znj. Anxhela Shehu, Z.Ledjon Shehaj.

Kryetari i Këshillit e hap mbledhjen me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes më datë 26.06.2025.
3. **Projektvendim Nr.26:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.
4. **Projektvendim Nr.27:** Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028.
5. **Projektvendim Nr.29:** Për përdorimin e fondeve të kushtëzuara të mbrojtjes civile për vitin 2025.
6. **Projektvendim Nr.30:** Për dhënien në përdorim për një afat deri në 10-vjet, të sipërfaqes pyjore 1.2 ha, ngastra me nr.35, ekonomia kullososre Ballsh-Fratar, për qëllime pushimi, argëtimi dhe veprimtari turistike.
7. **Diskutime** të tjera në lidhje më kërkesat e qytetarëve.

Në zarf keni pasur dhe një projektvendim tjetër, i cili nuk është në rendin e ditës, pork a ardhur si material. Projektvendimi Nr.31: Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit për bashkëpunim ndërkufitar AOOs-Vjosa. Në mbledhjen e kryesisë u paraqit një material për njohje, por është parë e arsyeshme për t'u kthyer në projektvendim, ju takon juve për të vendosur nëse doni t'a kaoni në rend dite.

Kush është dakord për rendin e ditës? Votojnë 11 pro, asnjë kundër. Miratohet. I shtohet dhe një këshilltarë mbledhje, duke shkuar numri i anëtarve në 12.

Kalojmë te pika 2, lexohen katër vendimet e mbledhje datë 26 qershor 2025.

Kalojmë me pikën 3: Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.- kush ka diçka?

Znj. Anxhela Shehu: ka pasur ndryshime te lista e qëndrorit dy familje, kurse nga vendor s'ka pasur ndryshime.

Z. Lefter Rabiak: këta që hiqen nga lista e qëndrorit, kalojne automatikisht te vendor? Po pagesa e njëjtë është?

Znj. Anxhela Shehu: Po, kalojnë automatikisht, dhe pagesa e është e njëjt.

Z. Lafter Rabiak: Po pse dalin nga lista e sistemit të qëndrorit?

Znj. Anxhela Shehu: Ka arsye të ndryshme, p.sh dikush mund të blej një makinë, i ulen pikët në system, sepse quhet rritje e mirëqënies.

Z. Nexhmi Sulaj: Ka gjë tjetër, atëherë e hedhim në votim: votojnë 12 pro, asnjë kundër, asnjë apstenim. Miratohet.

Kalojmë me pikën 4: Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028.

Z. Aleksanër Rama: është i njëjt me projektvendimin e muajit të kaluar. Bashkia ka gjithsej 13 programe buxhetore, shpenzimet do te jenë në të njëjtin rend sin ë vitin 2025 dhe për vitet 2026-2027. Parashikimet bëhen në bazë të vitit 2025 do ketë pak më tepër investme në vitet në vazhdim.

Z.Nexhmi Sulaj: Klodjan, mqs kryetari i komisionit të ekonomisë nuk është, jut ë matematikës që merrni vesh nga shifrat, do shtonit ndonjë gjë në diskutim?

Z. Klodjan Shehaj: Jo, nuk kemi, plus që kjo do kalohet përsëri te buxheti.

Hidhet në votim, votojnë 12 pro, asnjë kundër, asnjë apstenim. Miratohet.

Kalojmë për pikën 5: Për përdorimin e fondeve të kushtëzuara të mbrojtjes civile për vitin 2025.

Z.Qerim Ismailaj: ky fond përdoret kryesisht për rindërtim banesash ose për parandalim të rriskut nga fatkeësitë natyrore. Vjet bërëm projektin për mbrojtjen lumore, por duke mos u realizuar procedurat në kohë, fondi u dogj. Sivjet, duke marr shkas dhe nga sítuate ku ndodhemi me zjarret, menduam të marrim një makinë pick-up, t'i montojmë një depozitë uji, sepse është i pamjaftueshëm si fond për të blerë zjarrfikëse, por gjithsesi është një ndihmë e madhe. Duke parë terrenin e Bashkisë Mallakastër, ky mjet është i nevojshëm, sepse aktualisht punonjsit përdorin edhe mjetet e tyre për të shkuar në vendet ku bie zjarri. Kurse për t'u pajisur me zjarrfikëse do të kërkojmë dhe ndihmën Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes nga Zjarri (AKMC). Mqs jemi në këto sítuate, do të doja të bëjmë dhe një sensibilizim qytetarëve, që t'a shmangin sa më shumë ndezjen e zjarreve për djegien e shkurreve që ata presin nga pastrami i ullinjëve ose pemëve të tjera, sepse fatkeqësisht në Drenovë u dogjën 2000 rrënjë ullinj.

Z. Lefter Rabiak: Kalojmë te rend ii ditës, sa efikase do të jetë kjo makinë, sa litra ujë do mbaj, kush do ta blej,etj?

Z.Qerim Ismailaj: kjo makinë do të përdoret për të transportuar punonjësit, por dhe për të shkuar aty ku zjarrfikësja nuk futet, do të mbaj një deposit dhjetë tonëshe. Ky fond është i parashikuar në buxhet, për emergjencat civile. Sa për vlerën, duam një makinë të re, dhe ky fond është nka fondi i kushtëzuar për emergjencat civile, jo nga buxheti i bashkisë.

Z.Lefter Rabiak: të blihet një mjet që të ketë efijencë.

Znj.Sabire Hoxhaj: Ne nuk jemi për t'a djegur këtë fond, por duket vlerë shumë e madhe për të blerë një makinë të till. Se pot ë duash këtyre lekëve ju shton dhe një vlerë nga bashkia dhe blen një zjarrfikëse.

Z.Qerim Ismailaj: jo, kjo nuk bëhet, ky është fond i ndarë vetëm për emergjencat civile.

Z.Bejkush Haxhij: në raste të veçanta, kjo makinë muns të bëj më shumë punë se zjarrfikësja, psh në një vend ku ska rrugë mjaftueshëm të gjerë për të kaluar zjarrfikësja.

Z.Nexhmi sulaj: të shtunën ra zjarr në Povël, puna më e madhe u bë nga punonjesit me pompat e krahut, që zjarri nuk mori përmasa të mëdha.

Hidhet në votim, votojnë 12 pro, asnjë kundër, asnjë apstenim. Miratohet.

Kalojmë në pikën gjashtë të rendit të ditës: Për dhënien në përdorim për një afat deri në 10-vjet, të sipërfaqes pyjore 1.2 ha, ngastra me nr.35, ekonomia kullosose Ballsh-Fratar, për qëllime pushimi, argëtimi dhe veprimtari turistike.

Z.Lefter Rabiaj: këtu thuhet me një afat 10-vjeçar, po pas 10 vjetësh çfarë do bëhet?

Z.Qerim Ismailaj: Kat ë drejtë rinovimi, nëse jo, ç'monohen dhe hiqen, sepse s'janë ndërtime me beton.

Z. Sabire Hoxhaj: Po ata që kullosin bagëtit atje, nuk do shkojnë më?

Z.Qerim Ismailaj: Kush do kullota me qera për bagëtin, le të vij, ka marrje me qera të tokave me një vlerë shumë të vogël, kjo i bie si zonë mbaskodrës së parë.

Z.Bejkush Haxhij: Mos ndoshta ishte deri në 1 ha sipërfaqja që merrej me qera, se kështu na that radhën e parë.

Z.Ledjon Shehaj: jo, deri në 1 ha ishte sipërfaqja e mundshme për tjetërsimin e pronës, kurse marrja me qera s'ka kufizim në sipërfaqe.

Z.Bejkush Haxhij: Nga këto vetëm të mira kemi, të këqija jo, do marrim taksa, do shkojnë njerëzit për fundjava, etj.

Z.Lefter Rabiaj: Këto projektide më pëlqejnë shumë, por se sa do jenë të realizueshme se di.

Znj. Sabire Hoxhaj: unë dua të jem Brenda ligjit, të mos ketë grindje atje, të mos ketë betonizim, sepse sot jam këtu, por ligji të ndjek dhe për 10-20 vjet.

Z.Klodjan Shehaj: Zotëria që ka bërë kërkesën ka sjell dhe projektin të bërë nga një studio e licensuar.  
Znj.Sabire Hoxhaj: Bashkia duhet të ketë vet një plan zhvillimi për territorin.

Z.Qerim Ismailaj: Për pjesën e pyjeve jemi conform ligjit, që pyjet mund të jepen me qera për të zhvilluar një lloj të caktuar aktiviteti, ne s'kemi plan tjetër zhvillimi, le të jepen me qera të tilla që e kërkojnë, sepse si do të zhvillohet zona ndryshe? Se nuk mund t'i vendosim në vendin ku do bëhet ky investim ose zhvillim, sepse e gjithë zona pyjore jepet me qera, përveç zonave që janë të mbrojtura.

Z. Klodjan Shehaj: Ne jemi te faza e dhënies me qera, personi që e merr është person juridik, ndiqet ai penalisht nëse bën tjetërsim ose diçka jashtë ligjit.

E hedhëm në votim, votojnë 9 pro, 2 kundër, asnjë apstenim. Nuk miratohet.

Kalojmë në projektvendimin Nr.31: Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit për bashkëpunim ndërkufitar AOOs-Vjosa. Atë ditë që u zhvillua mbledhja e kryesisë ishte si material, por është kthyer në projektvendim. Doni që ta kalojmë si rend dite? Votojnë 11 pro, 1 kundër, miratohet.

Z.Ledjan Shehaj: ky është një projekt për të menaxhimin e mbrojtjes së zonës lumore Vjosë, p.sh bizneset most ë krijojnë mbetje dhe derdhje ujërash të zeza në lum, etj.

Hidhet në votim, votojnë 11 pro, një kundër, miratohet.

Kalojmë në pikën shtatë: diskutime rreth kërkesave të qytetarëve.

1. Kërkesa e Z.Erton Isufaj: Për mbirëmbajtjen e qendrave shëndetësore.

Z. Qerim Ismailaj: Q.Sh kanë fondin 602, dhe t'i bëjnë vet mirëmbajtjet.

Z. Lefter Rabiaj: Te buxheti i miratuar nuk kam parë ndonjë zë për mirëmbajtjen e qendrave shëndetësore.

Z.Qerim Ismailaj: Do të shohim sit ë veprojmë në fazën tjetër të buxhetit.

2.- Kërkesa e Z.Mehdin Levani, për ndihmë financiare.

Z.qerim Ismailaj: Këta janë dy pensionist, por banesa e tyre është e vjetër dhe nuk kanë bërë investime me vite, dhe bashkia nuk ka mundësi të riparoj të gjitha këto shtëpi të kësaj gjendje, e vetmja zgjidhje është po aplikuar vitin tjetër te FShZh për rikonstruksion banesash, t'i kemi parasysh.

3.- Znj.Ylvia Meçaj: Kërkesë për ndihmë financiare.

Z.Nexhmi Sulaj: nësa ka mundësi të kanalizojmë kërkesën e saj, t'a ndihmojmë që të drejtohet te mjekët për të marr KEMP për fëmijën e sëmurë.

Z.Lefter Rabiaj: Këtu duhet të vendosim dorë dhe ne, për deri sa na është drejtuar, t'a dij që kjo si çështje u diskutua, të ngrihet një grup të shkojnë të verifikojnë dhe t;i drejtojnë ku duhet.

4.- Kërkesa e Z. Sulo Merkaj, nga fshati Kutë, për zaptim e tokës. Ju lutem ndërhyri për zgjidhjen e këtij konflikti.

Z. Sabire Hoxhaj:- Kjo nuk është kopentenca jonë, t'i drejtohen gjykatës.

Z.Bejkush Haxhiaj:- T;i Nënshtrohen ligjit, le të largohet personi që ka zaptuar tokën.

Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj, këtu mbyllet mbledhja!

MBAJTËS I PROCESVERBALIT  
SEKRETARI I KËSHILLIT

Zinaida Ahmetaj